



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.150 dt.16.11.2001

**PER  
MIRATIMIN E TRANSFERIMIT TE FONDEVE TE DELEGUARA**

Bazuar në Ligjin Nr.8652 dt.31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Bashkisë Tiranë”, Ligjit Nr.7776 dt.22.12.1993 “Për buxhetit lokal”, neni 6, Udhëzimit të Ministrisë së Financave Nr.2 dt.02.02.2001 pika5/a, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Tiranë, Këshilli Bashkiak

**V E N D O S I**

1. Të miratojë pakësimin e fondeve të deleguara të pakonsumuara në artikullin 600 (paga) në shumën 6.300 mijë lekë dhe në artikullin 601 (sigurime shoqërore) në shumën 2.820 mijë lekë për Njësitë Bashkiake sipas tabelës bashkëlidhur duke i kaluar në favor të Aparatit të Bashkisë, sipas zërave përkatës
2. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Burimeve Ekonomike, Drejtoria e Financës dhe Njësitë Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**Leonidha TOSKA**





